



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2905 prot.

Himarë, më 07.04 .2025

VENDIM

Nr. 18 datë, 02 . 04 .2025

**Për një ndryshim në vendimin nr. 28 datë 29.08.2024 të Këshillit Bashkiak,
“Për miratimin e niveleve të pagave të punonjësve të Bashkisë Himarë”**

Në mbështetje të nenit 54 të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, nenit 9, të ligjit nr. 35/2023, “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi”, nenit 28, të ligjit nr. 89/2022 “Për policinë bashkiake”, vendimit nr. 328, datë 31.05.2023 të Këshillit të Ministrave “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar me VKM nr. 503, datë 01.08.2024, vendimit nr. 326, datë 31.05.2023 të Këshillit të Ministrave “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike”, i ndryshuar me VKM nr. 422, datë 26.06.2024, vendimit nr. 425, datë 26.06.2024 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jomësimorë në institucionet arsimore dhe në institucionet plotësuese të sistemit arsimor parauniversitar”, vendimit nr. 419, datë 26.06.2024 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e vlerave për secilin element përbërës të pagës bruto mujore të punonjësve të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”, vendimit nr. 325, datë 31.05.2023 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike”, i ndryshuar me VKM nr. 421, datë 26.06.2024, vendimit nr. 39, datë 20.12.2024 të Këshillit Bashkiak Himarë “Për krijimin e ndërmarrjes së shërbimeve publike Himarë si institucion varësie të Bashkisë Himarë”. Këshilli Bashkiak Himarë në mbledhjen e datës 02.04.2025 pasi shqyrtoi materialin e sjell nga drejtoria përkatëse e miratoi me (19) nëntëmbëdhjetë vota pro , (1) një kundër , (0) zero abstenim dhe si më poshtë vijon,

VENDOSI:

1. Te vendimi nr. 28, datë 29.08.2024 të Këshillit Bashkiak, “Për miratimin e niveleve të pagave të punonjësve të Bashkisë Himarë”, pas lidhjes nr. 10, të shtohet lidhja nr. 11 me titull “Niveli i pagave për punonjësit e ndërmarrjes së shërbimeve publike Himarë si institucion varësie të Bashkisë Himarë”, bashkëngjitur këtij vendimi.

2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi do të përballohen nga buxheti i Bashkisë Himarë.
3. Ndryshimet e këtij vendimi të pasqyrohen në vendimin nr. 39, datë 20.12.2024 të Këshillit Bashkiak Himarë “Për krijimin e ndërmarrjes së shërbimeve publike Himarë si institucion varësie të Bashkisë Himarë”
4. Ngarkohen *drejtoria e burimeve njerëzore, informacionit dhe shërbimeve digjitale, drejtoria e zhvillimit ekonomik, ndërmarrja e shërbimeve publike*, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i dryshuar.

KRYETARI

Dhimitër Kapaj



**Lidhja nr. 11 – Niveli i pagave për punonjësit e ndërmarrjes së shërbimeve publike
Himarë si institucion varësie të Bashkisë Himarë.**

a) Punonjësit e administratës:

Klasa	Emërtesat e pozicioneve të punës	Grupi i diplomës	Paga për pozicion
II-2	Drejtor i ndërmarrjes	1	141.000
III-2	Përgjegjës sektori	1 ose 2 ose 3	105.000
IV-3	Specialist	1 ose 2 ose 3	70.000
	Punonjës administrativ (Arsim i mesëm)		47.000

Punonjësit e administratës, përfitojnë edhe shtesën për vjetërsi në punë, e cila jepet në masën:

- i. 0.6% pas çdo viti pune për 10 vitet e para (1–10 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit;
- ii. 0.8% pas çdo viti pune për 10 vitet e dyta (11–20 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit;
- iii. 1% pas çdo viti pune për 10 vitet e treta (21–30 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit;

Për efekt të llogaritjes së kësaj shtese, “vite pune” do të konsiderohet vjetërsia e përgjithshme në punë, e dokumentuar në librezën e punës së çdo punonjësi, apo, në mungesë të librezës së punës, me çdo dokument tjetër ligjor, të lëshuar nga organet kompetente përkatëse sipas legjislacionit në fuqi, me përjashtim të viteve të sigurimit vullnetar, vetëpunësimit, shërbimit ushtarak të detyrueshëm, viteve të shkollimit në institucionet e arsimit të lartë, si dhe periudhës së trajtimit me pagesë papunësie.

b) Punonjësit mbështetës:

Emërtesat e pozicioneve të punës	Klasa	Vjetërsia	Paga bazë	Shtesa për natyrë të veçantë pune
Manovrator	XIII	1%	46.700	4.000
Teknikë të mesëm të specialiteteve të ndryshme	V	1%	42.800	4.000
Elektricitist	V	1%	42.800	4.000
Hidraulik	V	1%	42.800	4.000
Magazininier	IV	1%	42.500	4.000

Shofer	III	1%	41.800	4.000
Punonjës mirëmbajtës të profesioneve të ndryshme	III	1%	41.800	4.000
Punëtor mirëmbajtjeje	III	1%	41.800	4.000
Punëtor pastrimi/Sanitar	I	1%	40.000	4.000
Roje objektsh	I	1%	40.000	4.000

Shënim: Shtesa për natyrë të veçantë pune është caktuar në zbatim të gërmës *m*, të pikës 1, të VKM-së nr. 422, datë 26.06.2024 “Për një ndryshim në vendimin nr. 326, datë 31.5.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike”, të ndryshuar.

Shtesa për vjetërsi në punë llogaritet për çdo vit pune, në masën 1 (një) për qind të pagës bazë për klasë, por jo më shumë se 25 (njëzet e pesë) vjet. Për efekt të llogaritjes së kësaj shtese, “vite pune” do të konsiderohet vjetërsia e përgjithshme në punë, e dokumentuar në librezën e punës së çdo punonjësi, apo, në mungesë të librezës së punës, me çdo dokument tjetër ligjor, të lëshuar nga organet kompetente përkatëse, sipas legjislacionit në fuqi. Përfshihen nga kjo llogaritje vitet e sigurimit vullnetar, vetëpunësimit, shërbimit ushtarak për meshkujt, vitet e shkollimit në institucionet e arsimit të lartë dhe periudha e trajtimit me pagesë papunësie.

KRYETARI

Dhimitër Kapaj

